

## **Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në Austrinë e epërme(e sipërme) në një nga objektet e kujdesit për fëmijët si (cerdhet, kopshti, si dhe kopshtet mbas mësimi shkollorë)**

### **Kushtet e parashtruara:**

- Regjistrimi nëpërmjet prindërve në një nga këto objekte që kujdesen për fëmijët në austrinë e Eperme (e sipërme)
- Raportimi nga një mjek specialist, si dhe mendimi i një psikologu (F1)
- Pëlqimi i prindërve për përfshirjen e këshilluesve ekspertëve për integrim (F2a)

Nëqoftëse në objektin e sipërmëndur të kujdesjes së fëmijëve paraqiten dokumentat e lartpërmendura (F1, F2a), do të jetë drejtoresha e objektit që do të kontaktojë me specialistin për integrim.

### **Forlmularët e nevojshëm meren nëpërmjet drejtoreshës së objektit përkatës**

Qendra për integrim punon në emër të institucionit (Land OÖ) të rrethit të austrisë së Epërme (e sipërme) austri.

**Qëllimi është integrimi shoqëror si dhe sigurimi i masave që ndihmojnë zhvillimin për fëmijët me nevoja të veçanta.**

Nuk është detyra e FBI (Konsultimit për integrim) që të mbulojë periudhën e pranisë së çdo fëmije nëpërmjet personelit përkatës por është përgjegjësia e institucionit llogaridhënës. Nëqoftëse ju keni pyetje mbi integrimin në një nga objektet që kujdesen për fëmijët, jeni të mirëpritur dhe mund tju drejtoheni ekspertëve për integrim.

Detajet e kontaktimit të këshilltarit kompetent për integrim në rrethin tuaj e gjeniduke vizituar adresen e internetit [www.integrationsberatung.at](http://www.integrationsberatung.at) ose mund ti merni në numrin e tel 0732/76102271!

## **Procedura në vijim**

- Konsultimi për Integrim (FBI) e shqyrton nevojën duke vëzhguar fëmijën, duke biseduar me prindërit, si dhe me personin me funksion juridik, edhe me drejtuesit e objektit po ashtu edhe me personelin arsimor
- Është e nevojshme formulimi i masave ndihmuese , shoqërimin e fëmijës si dhe organizimin e orëve të personelit
- Krijimin e kuadrit të përshtatshëm nën konsultimin e këshilltarit juridik për  
(madhësinë e grupit, personelin e duhur, si dhe mjetet e nevojshme, ..)
- Këshillimi arsimor si dhe zbatimi i masave të vecanta individuale nëpërmjet masave të vecanta mbështetase nëpërmjet këshilluesit profesional për integrim në bashkëpunim me stafin arsimor, si dhe këshillimi i prindërve gjithmonë me pëlqimin e tyre ,dhe po ashtu edhe kordinimi i takimeve me organet e tjera si mjekë, terapistë, e shkolla.!